



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2020:060233

Datë: 31.05.2022

Numri i dokumentit: 03076656

E.nr.933/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbaremore të kreditorës Z.S nga fsh .... Komuna e Ferizajt, të cilën e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Qendra e Shëndetit Mendor në Ferizaj, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 30.05.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

PËRFUNDON procedura përmbaremore në lëndën E.nr.933/21, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorës.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.933/21, të datës 21.07.2021, e ka caktuar përmbaremin e propozuar nga i autorizuari i kreditorës, kundër debitorit Qendra e Shëndetit Mendor në Ferizaj, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.842/20, të datës 02.11.2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbaremit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 17.12.2021, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,178.67 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbaremore në këtë çështje juridike përmbaremore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
E.nr.933/21, më datë 30.05.2022

**GJYQTARI**  
Faton Ajvazi